



Njoftim për konsultim publik

Titulli i Projekt-aktit : "Mbledhja e rekomandimeve për prioritetet e komunitetit për projekt buxhetin afatmesëm 2022 – 2024"

Propozuesi : Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

Sqarime për projekt-aktin : Bashkia Prrenjas do të informojë komunitetin mbi të dhënat e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të bashkisë si edhe shërbimet të ofruara nga bashkia. Qëllimi i këtij konsultimi është të mblidhen sugjerimet e komunitetit lidhur me:

- Mënyrën si janë shpenzuar fondet për ofrimin e shërbimeve nga bashkia.
- Performancën e shërbimeve të ofruara nga bashkia.
- Shërbimet prioritare të komunitetit.

Kalendari i konsultimit : Konsultimet do të realizohen sipas Kalendarin e Këshillimit Publik.

Pjesëmarrës :

- **Nga ana e Bashkisë :** Drejtoria e Financë, Urbanistikës, Drejtoria e të ardhurave, lejeve dhe licensave, Drejtoria e Punëve Publike, përfaqësues të Këshillit të Bashkisë, Sekretari i Këshillit dhe Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
- **Nga komuniteti :** Banorë të zonës në çdo njësi administrative, Përfaqësues të biznesit, Oj, anëtarë të komunitetit, prindër, mësues, kryetar fshatrash.

Format e konsultimit : Takime publike, takim me banorët sipas kalendarit si dhe pritja e propozimeve dhe sygjerrimeve të tyre me shkrim në zyrën me një ndalesë si dhe kontaktimi i tyre me përfaqësuesin e tyre në KB, gjithashtu mund të merrni pjesë duke u bërë pjesë e sondazhit :

<https://eur01.safelinks.protection.outlook.com/?url=https%3A%2F%2Fforms.office.com%2FPages%2FResponsePage.aspx%3Fid%3DDQSIkWdsW0yxEjajBLZtrQAAAAAAAAAAAAAYAAIBWQCRUNehBQjIwNVI2TExLN0E5MVBZMIg0UEVOMy4u&data=04%7C01%7CCornela.shapo%40giz.de%7C11abe5d6fad8475ca90108d8f4e444df%7C5bbab28cdef3460488225e707da8dba8%7C0%7C0%7C637528608532056420%7CUnknown%7CTWFpbGZsb3d8eyJWIjoiMC4wLjAwMDAiLCJQIjoiV2luMzIiLCJBTiI6IkhWwiLCJXVCi6Mn0%3D%7C1000&sdata=aAto5Md4B5LGjo1VfaDtcugt5ZprxXmE6B41qlnEDIQ%3D&reserved=0>

<p>Qëllimi i konsultimit publik</p>	<p>publik synon tërheqjen e mendimit të qytetarëve, biznesit, shoqërisë civile, mësuesve , kryetar fshatrash lidhur me prioritetet që kanë për shërbimet / funksionet e ofruara nga Bashkia.</p> <p>Këshilli i Bashkisë, si përfaqësues i komunitetit, kërkon të marrë më shumë informacion mbi mendimin e komunitetit për përdorimin e fondeve publike për ofrimin e shërbimeve nga ana e Bashkisë, performancën e ofrimit të shërbimeve si dhe cilët janë shërbimet / funksionet që konsiderohen prioritare nga komuniteti. Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit, do t'i shërbejë bashkisë për të përcaktuar se si do të përdoren fondet publike në ofrimin e shërbimeve për tre vitet e ardhëshme 2022 –2024, dhe të sigurojë që përdorimi i tyre është në përputhje me nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve prioritare të përcaktuara nga to.</p>
<p>Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti</p>	<p>Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të konsultojë me komunitetin shpenzimet e parashikuara (tavanet e programeve) nga Bashkia për çdo shërbim dhe performancën e bashkisë në vitin 2021.</p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Bazuar në Ligjin 139/2015 Neni 18, ka vendosur kalimin në konsultim publik për përgatitjen e projekt buxhetit afatmesëm duke përdorur sondazhin online. Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë? 2. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2022 – 2024? 3. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur? 4. Tjetër

<p>Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktin për këshillim;</p>	<p>Bashkia Prrenjas në bashkëpunim me Këshillin e Bashkisë do të organizojnë konsultime publike 1 me banorët e bashkisë Prrenjas dhe 3 në NJA (Qukës, Rrajcë, Stravaj) në një takim publik, sepse të gjithë përfitojnë nga ky konsultim.</p> <p>Këshilli do të konsultohet me biznese, mësues, OJF, Kryetarët e Fshatrave, banorë të zonës.</p> <p>Konsultimi publik do të publikohet pyetësoni edhe në faqen e të Këshillit të Bashkisë dhe të bashkisë.</p> <p>Konsultimi do të realizohet sipas Kalendarit të Konsultimit Publik të publikuar.</p>
<p>Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;</p>	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen direkt nëpërmjet pjesmarrjes suaj në takimet publik, por në pamundësi për të marrë pjesë në këto konsultime do të na ndihmoni duke dhënë sygjerimet e tyre pranë zyrave me një ndalese, si dhe duke kontaktuar me përfaqesuesin e komunitetit si dhe mund të dërgohen në adresën e emailit të KB ose të dërgohen me postë BRENDA DATËS 30.11.2021</p> <p>Email: keshillibashkiakprrenjas@gmail.com</p> <p>www.bashkiaprrenjas.gov.al</p> <p>Adresa: Këshilli i Bashkisë, Adr. Rr. "Skënderbeu", godina 15</p>
<p>Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundëshme</p>	<p>Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit :Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.</p>
<p>Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet</p>	<p>Raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2020, së bashku me tavanet përgatitore të projekt buxhetit afatmesëm 2022 - 2024 mund t'i gjeni në linkun: www.bashkiaprrenjas.gov.al</p>

<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas realizimit të konsultimeve publike me komunitetin dhe grupet e interesit,</p> <p>Bashkia Prrenjas dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtja e procesverbalit të çdo takimi publik . 2. Marrja e Rekomandimeve me postë . 3. Realizimin dhe përmbledhje të rekomandimeve, që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje. 4. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës dhe çdo këshilltari. 5. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës (mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të çdo rekomandimi dhe diskutimi i tij në komision për të dalë me një vendim se cilat propozime mund të merren në konsideratë dhe cilat nuk mund të merren dhe për çfarë arsye. 6. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor. 7. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit. 8. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre. 9. Publikimi i aktit në faqen e dhe në tabelat e informimit 10. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar 11. Monitorimi i zbatimit të tij
<p>Data e publikimit</p>	<p>18.10.2021</p>

